

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE –Departamenti për Krime te Rënda, Kryetar i Trupit Gjykuese Gjyqtari Shaqir Zika, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit T.H. Kryeziu nga fshati B. K- D. , për shkak te veprës penale, falsifikimi i parasë nga neni 302 prg 2 te KPRK-se, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime te Rënda në Gjakovë PP/I. nr.12/2018 datë 22.02.2018, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit fillestar të mbajtur më datën 11.05.2018, me pjesëmarrjen e Prokurorit të Shtetit te PTH ne Gjakovë Ali Uka, të akuzuarit T. K. muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **T. K.** nga i ati H., dhe ëma S. e gjinisë G. , i lindur me ne fshatin B. K-D. ku dhe jeton, i martuar i ati i dy fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas e R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me dt. ..., duke qene ne dijeni se paraja është e falsifikuar ne fshatin R. K- R. pikërisht ne tregun e pemëve dhe perimeve ka vene ne qarkullim një kartëmonedhë prej 10€, me numër serik ..., ne atë mënyre qe ditën kritike rreth orës 11:50 min, i pandehuri T. i ja jep të miturit D.H. këto 10€, te cilat ky i mitur me pastaj ja jep hallës së tij, e moshës 10 vjeçe me te cilat te holla ka tentuar qe blejë pemë ne çmim prej 2€, dhe atë nga shitësi i dëmtuari A. H. nga fshati R. K- R. , ashtu qe gjate punës operative nga ana e policisë, si dhe kontrollit dhe bastisjes se bërë ne shtëpinë e të miturit D.H. janë gjetur dhe sekuestruar edhe një kartëmonedhë tjetër prej 10€, me numër te njëjtë serik, ashtu qe i pandehuri menjëherë është arrestuar nga ana e policisë.

- me çka ka kryer veprën penale falsifikimi i paras nga neni 302 prg 2 te KPRK-së.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 6, 17, 41, 49, 50, 51, 52, 62, 73, 76 pika 1.5 dhe nenit 302 par. 2 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së, ia shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ja shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri ne afat prej 1 (një)viti, nga dita kur ky aktgjykim te behet i formës së prere nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I shqiptohet dënimi plotësuese i konfiskohet dy karte monedha nga 10€, me numër serik te njëjte

Obligohet i akuzuarit që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 30,00 € në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP/I. nr. 12/18 të datës ..., ka akuzuar te akuzuarin T. K. nga fshati B. K-D. , për shkak te veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 prg 2 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 11.05.2018, ku prezent ka qene përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ali Uka, i akuzuari T. K. , ndërsa nuk ka qene prezent i dëmtuari A. H. edhe pse i ftuar me kohe dhe me rregull mungesën nuk e ka arsyetuar. Dhe i njëjti ka dhënë deklaratë ne polici, se nga prindi i të miturës D.H. është kompozuar ne vlere prej 20€.

Pas leximit te aktakuzës ne seancën e shqyrtimit fillestar, i akuzuari T. K. është deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për vepër penale për të cilën akuzohet dhe është deklaruar i fajshëm ka pranuar fajësinë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar te akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimi te fajësisë ne kuptim ne nenit 326 te KPPK-se, kështu qe pas shpjegimeve te bëra nga kryetari i Trupit Gjykuese, i akuzuari ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rendësin e pranimi te fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje te vullnetit te tij te lire, pasi qe është kryes i kësaj vepre penale andaj ne tërësi ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat te cilat i janë ofruar Gjykatës ne aktakuze dhe ata kallëzimi penal i ushtruar nga ana e Stacionit Policor në Rahovec, Njësi i Hetimeve me numër te rastit ... te dt. 15.01.2018, nga raporti i oficerit policor Rr. B. me numër te dt. 14.01.2018, shikimit ne vërtetimin e konfiskimit e kartëmonedhës si dhe shikimit ne raportin te Agjensionit te Kosovës për Forenzike ne Prishtinë, ..., te dt. 30.01.2018, ku nga kjo ekspertize te dyja kartëmonedha ne apoen prej 10€ me numër serik janë plotësisht te falsifikuara si dhe nga deklarata e të dëmtuarit A.H. dhe dëshmitarit i mituri D. H. si dhe nga mbrojtja e te akuzuarit T. K.

Pas deklarimit te akuzuarit T. K. për pranimin e fajësisë Kryetari i Trupit Gjykuese kërkoi qe jep mendimin Prokurori i Shtetit.

Prokurori i Shtetit Ali Uka deklaron se: këtu i akuzuari T. K. ne këtë seancë te shqyrtimit fillestar pranoi fajësinë për vepër penale falsifikimi i parasë nga neni 302 prg 2 te KPRK-se, i akuzuari ne aktakuze, duke qene te bindur se ky pranim i fajësisë nga ana e tij është bërë me vullnet dhe pa presion , i njëjti ka kuptuar pasojat e pranimi te fajësisë dhe pranimi i fajësisë mbështet edhe ne provat e siguruara gjate procedurës hetimore, e këto prova te siguruara ne aktakuze, andaj i propozoi Kryetarit te Trupit Gjykuese qe te aprovoi pranimin e fajësisë njëkohësisht ti shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohet kartëmonedha e falsifikuara si dhe te obligohet ne pagimin e shpenzime te procedurës dhe paushallit gjyqësor.

Gjate shqiptimit te dënimit Gjykata do te ketë parasysh te gjitha rrethanat që ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë gjendjen e tij ekonomike dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi i parapare sipas Ligjit.

Ne vijim Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana te akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehjen e vullnetit te lire te akuzuarit pasi qe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, dhe pranimi i fajit është bërë pas shpjegimeve te nevojshme nga ana e Kryetarit te Trupit Gjykuese dhe ky pranimi mbështet ne provat qe janë ne aktakuze komform nënti 326 te KPK-se.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajit nga ana të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, andaj ne veprimet e të akuzuarit ekzistojnë te gjitha tiparet e veprës penale nga neni 302 prg 2 te KPRK-se, për të cilën vepër penale i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes se dënimit Gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat qe ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit pendimit e tij, sjelljen korrekte, është mbajtës i vetëm i familjes, i atij dy fëmijëve, me herët nuk ka qene i gjykuar, gjendjen e tij ekonomike, andaj Gjykata ne rastin konkrete ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit dhe i ka shqiptuar dënimin me kusht me shprese dhe bindje se edhe me dënimin e shqiptuar dot e arrihet qëllimi i dënimit i parapare komform dispozitave te nenit 41 te KPRK-se.

Vendimi mbi konfiskimin e parasë, bazohet ne dispozitat e nënti 69 te KPRK-se.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË,- Department per Krime të Rënda
PKR. nr. 10/18 më date 11.05.2018**

**Sekretarja juridike
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afet prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.